**V E N D I M**
**Nr. 34, datë 17.1.1998**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.355, DATË 13.5.1996 "PËR KRYERJEN E REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE"**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Institutit të Statistikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.355, datë 13.5.1996, fjalia e dytë e pikës 1 ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi i njësive ekonomike bujqësore do të fillojë në muajin qershor të vitit 1998".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**